



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

Për:	Ertan Munoglu – Menaxher i Programit
Nga:	Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume
Kopje:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv
Data :	29 prill 2011
Subjekti :	Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Inspeksion Komunal

HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Inspeksion Komunal me datën 29 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z. Bajram Beqiri – Kryesues, dhe anëtarët z. Shefik Sylejmani, znj. Hyrije Thaçi dhe z. Pajazit Hamza. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Inspeksion Komunal dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

PËRMBLEDHJE:

Mbledhjen e hapi z. Bajram Beqiri me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunitat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Një çështje tjetër e ngritur dhe me shumë rëndësi ishte edhe ajo e Ligjit të ri për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, lidhur më këtë çështje z. Beqiri theksoj se ligji i ri nuk është i keq por komunitat është i pakapshëm dhe ka implikime buxhetore për komunitat, më tutje shtoi se centralizimi i kompetencave të inspektoratit të tregut zvogëlojnë të hyrat komunale, andaj është me rëndësi që bashkëpunimi me ministrinë të vazhdon por jo të kalojnë të gjitha kompetencat e inspektorëve në ministri. Do të ishte mirë që përmes akteve normative të tejkalohet kjo gjendje në mes komunave dhe ministrisë rreth kompetencave të inspektorëve komunal.

z. Sylejmani sqaroi se nuk ka pasur këshillime me komunitat për këtë ligj, duke marrë parasysh se puna e inspektorëve është me një rëndësi të veçantë në efikasitetin e punës të komunave. Duhet të sqarohet nga ministria se cilat janë kompetencat e punës të inspektorëve karshi komunës si shkas se humb përgjegjësi e punës dhe raportimit për detyrat të cilat ata kryejnë. Më tutje theksoj se shqetësim është edhe çështja e ndryshimit të formave të licencimit të bizneseve (lejeve të punës) ku duhet të ketë edhe miratimin e komunës, informata të plota rreth regjistrimit të biznesit dhe fushëveprimit, si dhe sqarimit të kompetencave rreth lëshimit të licencave.

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës të kolegjiut për Inspeksion Komunal në vitin 2011.

- **Fusha e Legjislacionit** duke pasur për objektivë kompletimin e infrastrukturës ligjore si dhe sqarimin e kompetencave dhe plotësimi i procedurave për inspektim.
- **Bashkëpunim më i ngushtë ne institucionet relevante për zhvillim të mëtutjeshëm të inspektoratit komunal** duke pasur për objektivë përmirësimin e kushteve të punës dhe zhvillimin e kapaciteteve të inspektoratit komunal.

Takimi kishte për objektiv edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Inspeksion Komunal.

Takimi i radhës

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut për Inspeksion Komunal të mbahet të mërkurën me datën 25.05.2011 në Viti.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut
2. Pjesëmarrje në Grupin Punues për Ligjet relevante
3. Prezantim i Drejtorit të Inspektoratit të Komunës së Vitisë rreth procedurave për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm
4. Ndarja në dy grupe dhe vizitë bizneseve në Viti
5. Të ndryshme

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.